



Pranuar / Dorezuar / Priljena / Prodato / Received / Delivery	12.04	2023	3	viti god year
Organ / Njesta / Organ / Jedinica / Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKP/SHK/	3503/2023		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.355/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.355/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.355/2023 e datës 14.02.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 06.02.2023 për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesen.

A r s y e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve-Inspektorati i Punës, e pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, më datë 14.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, e cila është protokolluar me numër:1732/2023 nën shenjen A.nr.355/2023, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës të datës 06.02.2023, me pretendimin ankimor se vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 22.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 07.03.2023 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 14.02.2023 me Nr.Prot:1732/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti vjetor 2022 i punës për periudhën kohore 01.01.2022 deri 30.12.2022, Plani Vjetor i punës-2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Plani i punës për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022; E-mail i dërguar nga N.S drejtuar A.M i datës 18.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 06.02.2023; E-mail i dërguar nga N.S drejtuar A.M e datës 10.02.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 22.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 07.03.2023; Akt emërimi me nr.prot.38/2021 i datës 10.08.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 28.01.2022; Raporti Javor i punës për periudhën kohore 01.07.2022 deri 31.07.2022; Raporti Javor i punës për periudhën kohore 01.09.2022 deri 30.09.2022; Raporti Javor i punës për periudhën kohore 01.10.2022 deri 31.10.2022; Raporti Javor i punës për periudhën kohore 01.11.2022 deri 30.11.2022; Raporti Javor i punës për periudhën kohore 01.12.2022 deri 30.12.2022; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 10.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore dhe faktike që ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 10.08.2021 mbanë pozitën "Drejtore të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme" në Inspektoratin e Punës/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 06.02.2023 ankuesen e ka vlerësuar me notën e përgjithshme mesatare tre pikë tre (3.3).

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimin në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse,*

ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues., rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesja për periudhën e vitit 2022 lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizimit të objektivave të punës është vlerësuar më notë 3.3, ndërsa lidhur me pjesën e aftësive dhe shkathtësive profesionale është vlerësuar më notë 3.5, ku gjithsej nota e përgjithshme për këtë periudhë është 3.5.

Bazuar si me lart e në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 në paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, nota përfundimtare e vlerësimit nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", përkatësisht sipas këtij përcaktimi ligjor "mirë", vlerësohet nëpunësi civil i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës dhe ka treguar gjithashtu aftësi të pritshme të punës, kështu që mbi këtë bazë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendosjen e notës së përgjithshme 3.3 për ankuesen, ka vlerësuar së e njëjta ka përmbushur të gjitha objektivat e punës, andaj si rrjedhojë janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit së vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë më shkelje të dispozitave ligjore.

Nisur nga faktet si me lart, Kolegji i Këshillit konstaton së vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.355/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

